



Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE

9 nëntor 2012, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Përkujtues: Qeveria lokale të reflektoj dhe veproj mbi rekomandimet e shoqërisë civile

Gjatë dy muajve të kaluar të monitorimit të punës së Qeverisë Komunale të Prizrenit, EC Ma Ndryshe ka publikuar të gjeturat e hulumtimeve të ndryshme dhe bashkë me to ka ofruar edhe disa rekomandime për përmirësimin e gjendjes në sektorë të caktuar. Po ashtu në raste të caktuara ka reaguar ndaj çështjeve të ndjeshme dhe ka kërkuar veprim adekuat nga përgjegjësit e komunës së Prizrenit.

Meqë deri më tani nuk janë ndërmarrë hapa cilësorë për përmirësimin e gjendjes në fushat e caktuara, EC Ma Ndryshe e ka pa të udhës që rekomandimet e saja t'ia përkujtoj edhe njëherë Qeverisë Komunale të Prizrenit, në mënyrë që të ketë reflektim dhe veprim nga organet komunale.

Në pjesën e parë të shtatorit EC Ma Ndryshe pat shprehur shqetësimin rreth gjendjes së krijuar në fushën e urbanizimit dhe planifikimit hapësinor në Qendrën Historike të Prizrenit, ku ndërtimet po vazhdonin me shpërfillje të lejeve të ndërtimit të dhëna nga DUPH-ja. EC Ma Ndryshe pat kërkuar nga Kryetari Ramadan Muja që të iniciohen procedurat për rrënimin e të gjitha ndërtimeve pa leje dhe atyre që janë bërë jashtë kriterëve të ndërtimit, në Qendrën Historike të Prizrenit dhe kështu të ndalohet trendi i degradimit urban të pjesës historike të qytetit. Në këtë pikë nuk ka pas ndonjë veprim konkret. Prandaj EC Ma Ndryshe përsërit se: "Ekzekutivi komunal duhet të ndërmarrë veprime konkrete parandaluese, ndërsa në rast të vazhdimit të punimeve, edhe veprime ndëshkuese ndaj personave që nuk i respektojnë kriteret e ndërtimit".

EC Ma Ndryshe, në pjesën e dytë të shtatorit gjatë hulumtimeve të bëra ka hasur në një rast, i cili ishte shqetësues për arsye se paratë publike janë investuar në një hapësirë, e cila vazhdon të jetë subjekt i kontestit pronësor, tani në shqyrtim në Gjykatën Supreme të Kosovës. EC Ma Ndryshe pat potencuar se qeveria lokale është dashur që të shter të gjitha mundësitë ligjore para se të orientonte paratë publike në një hapësirë që ka kontest pronësor. EC Ma Ndryshe insiston që ky rast të shërbej si shembull për mos përsëritjen e praktikave të tilla në të ardhmen, që mund të rezultojnë me humbjen e parave nga fondet publike sikurse edhe lëkundjen e besimit në institucione e gjyqësor.

Gjatë muajit shtator, EC Ma Ndryshe ka publikuar edhe një reagim në lidhje me vendosjen e shiritave për ndërprerjen e punimeve në vend punishte të ndryshme brenda zonës urbane të Prizrenit. Mirëpo, mos respektimi i kësaj mase dhe largimi i shiritave të inspektorëve, sikurse edhe vazhdimi i punimeve nga ana e investitorëve përkundër urdhrit zyrtar paraqet një shqetësim që lidhet drejtpërdrejtë me funksionimin e institucioneve shtetërore. Prandaj EC Ma Ndryshe ia përkujton thirrjen "të gjitha institucioneve të pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe atij gjyqësor të Prizrenit që të ndërmarrin veprime të duhura në kuadër të kompetencave që kanë dhe të sigurojnë zbatimin e ligjit në sektorin e urbanizimit".

Në bazë të gjeturave të një hulumtimi të publikuar në tetor EC Ma Ndryshe pat konstatuar se së paku tre këshilltarë të kryetarit të komunës, Ramadan Muja dhe një zyrtare e lartë e DKA-së marrin paga për vendet e tyre të punës në ekzekutivin lokal dhe në të njëjtën kohë janë pjesë e listës së pagave të shërbimit arsimor.

Në këtë aspekt nuk ka pas veprime konkrete nga lidhshipi komunal.

Nga autoritetet komunale EC Ma Ndryshe përsëri kërkon “aplikimin e standardeve të larta morale në mënyrë që të krijohet hapësira e duhur për punësimin e kuadrove të reja, në kushte të barabarta dhe pa ndikime partiake e politike, me qëllim të avancimit të cilësisë së shërbimeve arsimore”.

EC Ma Ndryshe në periudhën raportuese ka siguruar edhe shkresën shpjeguese të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) drejtuar komunave të Kosovës, përmes të cilës sqarohet se kushtëzimi i shërbimeve të komunës ndaj qytetarëve me pagesën e borxheve ndaj Ndërmarrjeve Publike Rajonale e Lokale, nuk kanë bazë ligjore dhe se si të tilla nuk mund të aplikohen. EC Ma Ndryshe përmes reagimit të saj i pat bërë thirrje kryetarit të komunës dhe kryesuesit të KK-së që në afatin sa më të shkurtër kohor të respektojnë shkresën e MAPL-së dhe të ndërmarrin veprimet e duhura në drejtim të anulimit të vendimit jo-ligjor. Por as në këtë pikë nuk ka pas veprim nga kryetari dhe KK-ja.

EC Ma Ndryshe rikujton se “sqarimet e MAPL-së në këtë drejtim janë të qarta dhe se ato duhet të zbatohen pa asnjë vonesë, me qëllim të mos cenimit të drejtave të qytetarëve të komunës së Prizrenit”.

Monitoruesit e EC Ma Ndryshe dhe të KDI-së patën shprehur shqetësimin e tyre me praktikën e fundit të ekzekutivit dhe legjislativit të Prizrenit që rregullorja për trajtimin e ndërtimeve pa leje miratohet pa u vënë në sprovën e publikut, respektivisht pa u testuar nëse është në interesin e qytetarëve apo jo, përmes debatit të mirëfilltë publik.

EC Ma Ndryshe përkujton se kryetari i komunës dhe KK-ja duhet të përmirësojnë këtë defekt procedural.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese

OJQ EC Ma Ndryshe

Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren

Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë

www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org

+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

*Projekti "Transparenca online e komunës së Prizrenit" prej muajit shtator 2012
përkrahët financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*